



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.375-2/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Llazić, Afjete Sada – Gllogjani, Kymete Kimete, Zyhdi Haziri, Rrustem Thaqi, Ferki Xhaferi, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur ndaj Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me seli në Prishtinë, për shkak të mos procedimit të 4,639 fletëvotimeve, të votuesve jashtë Kosovës si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të te njëjtave në QNR, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 28.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.375/2019 i datës 17.10.2019, me të cilin ka kërkuar të Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që t'i bart në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), 4639 (katërmijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) pako me fletëvotime për numërim të dërguara me postë nga qytetarët (votuesit) jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2019 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.375/2019 i datës 17.10.2019, kundër KQZ-së, me të cilën theksohet se me datë 16.10.2019, rreth orës 23:00, ka përfunduar numërimi i fletëvotimeve me post, nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë vendit, me të cilën janë numëruar gjithsejtë 13,491 fletëvotime të ardhura me 11,922 dërgesa postare. Paraqitësi i apelit pretendon se nga vëzhguesit e tyre janë informuar se edhe 4,639, pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk janë numëruar në QNR. Më tutje paraqitësi i apelit, thekson se pakot prej 4,639 fletëvotimeve janë të domosdoshme të numërohen për faktin se përmes këtij numërimi realizohet vullneti i qytetarëve të cilët jetojnë jashtë vendit si dhe me këtë realizohet e drejta kushtetuese e tyre për të zgjedhur, siç parashihet me nenin 45, të Kushtetutës së Kosovës. Në kuptim të dispozitës Kushtetuese, konkretisht nenit 45 paragrafi 1 dhe 2, si dhe me qëllim të realizimit të plotë të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, duke iu dhënë e drejta, të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës, përmes votës demokratike me të cilën kërkojnë nga PZAP-i, që të urdhërohet KQZ-ja, t'i bartë në QNR,

4,639 pako me fletëvotime për numërim të dërguara me postë nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës.

KQZ-ja, përmes përgjigjes në apel, të datës 17.10.2019, thekson se në mbledhjen e KQZ-së, të datës 12.10.2019, me numër 50/2019, një ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe raporti lidhur me procesin e votimit jashtë Kosovës. Raporti lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, i departamentit të operacioneve zgjedhore - divizioni i shërbimit votues (DVSH), e ka njoftuar KQZ-në, lidhur me pranimin e dërgesave postare pas afatit të periudhës së votimit përmes postës, se me datën 10 tetor 2019, në postën numër 6, janë pranuar 4,058 dërgesa postare, të cilat konsiderohen si dërgesa që kanë arritur pas afatit të periudhës së votimit përmes postës. Në vazhdim theksojnë se në raportin e DVSH-së, konstatohet se sipas numërimit dhe verifikimit të këtyre zarfeve, këto dërgesa postare janë nisur për në Kosovë, brenda periudhës së votimit. Numri i konsiderueshëm i këtyre dërgesave postare, si datë të nisjes kanë datat 19,20,23,25 e deri me 30 shtator 2019, dhe në bazë të nenit 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe nenit 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, votat jashtë Kosovës, duhet të pranohen nga KQZ-ja, 24 ore para ditës së Zgjedhjeve.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, këtë ankesë e ta trajtojë si apelim, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli, në rishqyrtim pasi vlerësoi pretendimet e palëve në procedurë, provat që gjenden me shkresat e lëndës si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A.A.-U.Zh.nr.19/2019, i datës 25.10.2019, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: në mes të palëve në procedurë, në këtë rast nuk është kontestuese se 4,639, pako me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove, janë pranuar nga KQZ-ja, nga data 08.10.2019 deri me datë 11.10.2019, pas ditës së zgjedhjeve të datës 06.10.2019, dhe nuk është kontestuese se këto pako me fletëvotime janë dorëzuar nga votuesit jashtë Kosovës, përmes postës në shtetin ku jetojnë nga data 19.09.2019, e deri me datë 30.09.2019.

Kontestuese në këtë rast mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotimeve, si të rregullta pasi që në KQZ, të njëjtat janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor, për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovë.

Paneli, konstaton se pretendimet e paraqitësit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, ngase KQZ-ja, drejt ka vepruar kur pakot me fletëvotime prej 4,639, të votuesve jashtë Kosovës, të cilat në KQZ, janë pranuar nga data 08.10.2019 deri më datë 11.10.2019, që nuk i ka bartur në QNR, për procedim të rregullt dhe numërim sepse: Me nenin 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcaktohet se: *“Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së”*, ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, përcaktohet se: *Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve*. Nga këto dispozita të lart cituara rezulton se pakot e fletëvotimeve të pranuar në kutinë postare 351, Posta nr.6, në Prishtinë e cila është hapur nga KQZ-ja, për pranimin e fletëvotimeve nga jashtë Vendit, andaj mbërritja e çdo pakoje

postare me fletëvotim, në këtë adresë brenda afateve të përcaktuara ligjore, konsiderohet e vlefshme, ndërsa fletëvotimet të cilat kanë arritur në këtë adresë, pas afatit të përcaktuar me nenin 96 parag.2 të LZP-së dhe nenit 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr.03/2013, siç është rasti me fletëvotimet për të cilat është ushtruar apeli, që janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve, të datës 06.10.2019, janë të pranuar pas afatit ligjor, prandaj të njëjtat nuk mund të procedohen si fletëvotime të vlefshme.

Paneli, i vlerësoi edhe vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna si në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Supreme, sa i përket aplikimit të nenit 127 të LPK-së, por se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), është ligj special (lex specialis) në raport me Ligjin Procedurës Kontestimore, krejt kjo duke u bazuar në parimin: “Lex specialis derogat lex gjenerali” apo Ligji i veçantë e derogon ligjin e përgjithshëm, që e rregullon vetëm procesin zgjedhore, mirëpo nëse dy ligje rregullojnë situatën e njëjtë faktike, ligji që rregullon fushën specifike siç është LZP-ja, mbizotëron ndaj ligjit që rregullon vetëm çështje gjenerale (lex generalis).

Në kuptim të kësaj Paneli, vlerëson se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë, ka përcaktuar afatin se kur fletëvotimet duhet të arrijnë në KQZ, për t’u trajtuar si të vlefshme (ky afat është 24 orë, para ditës së zgjedhjeve siç përcaktohet me nenin 96 paragrafi 2 të LZP-së dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013), dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me situata të pa përcaktuara më LZP-në dhe me Rregulla Zgjedhore, që mund të gjenin përshtatshmërisht zbatim dispozitat e LPK-së. Po ashtu në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me parashtrësia që dërgohen në një procedurë gjyqësore apo që i dërgohen gjykatës, në atë mënyrë që të gjenin zbatim dispozitat e LPK-së, por kemi të bëjmë me material të ndjeshëm, siç janë fletëvotimet që përcaktohet me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës 2019. Prandaj në këtë rast edhe afati për pranimin e këtyre pakove me fletëvotime, është specifik në krahasim me dorëzimin e parashtrësive që iu drejtohen gjykatave, për arsye se me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.3/2013, të KQZ-së, në këtë fazë të procesin zgjedhor nuk e përcaktojnë se të merret parasysh koha e dorëzimit në postë të fletëvotimit nga vendi dërgues, por e përcaktojnë se fletëvotimet duhet të arrijnë në KQZ, para zgjedhjeve, e më se largu 24 orë, para ditës së votimit.

Pretendimi i paraqitësit të apelit se në këtë rast me mos dërgimin në QNR, për tu numëruar këto fletëvotime, votuesve iu është cenuar apo mohuar e drejta për të zgjedhur sikurse garantohet me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar, për arsye se me asnjë veprim apo vendim KQZ-ja, nuk ua ka mohuar të njëjtëve të drejtën për të votuar, pasi që për ta shfrytëzuar të drejtën kushtetuese, për të votuar dhe zgjedhur janë përcaktuar rregullat se si mund të shfrytëzohet kjo e drejtë, siç është përcaktuar me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, të KQZ-së, çka do të thotë se të njëjtat duhet të arrijnë në KQZ, në afatin prej 24 orëve, para ditës së zgjedhjeve.

Paneli, me rastin e vendosjes, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të paraqitësit të apelit, por këto pretendime janë vlerësuar si të paqëndrueshme dhe pa ndikim për të vendosur ndryshe, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të drejta zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, por kemi të bëjmë me mosrespektim të afateve ligjore, të cilat afat janë prekluzive dhe nuk mund

të ndryshohen apo të zgjatën, por vetëm zbatohen siç janë të përcaktuara me ligj. Si votuesit brenda Kosovës, që kanë afat ligjore të votojnë në ditën e votimit kur hapen Qendrat e Votimit, në kuptim të nenit 88 paragrafi 1 i LZP-së, siç kanë votuar në këto zgjedhje me datë 06.10.2019, nga ora 07:00 e deri në ora 19:00, që sipas nenit 88 paragrafi 2 të LZP-së, askush nuk mund të hyjë në Qendrën e Votimit, për të votuar pasi që të mbyllet e njëjta, ashtu edhe për votuesit jashtë Kosovës, është kushti ligjor sipas nenit 96 paragrafi 2 të LZP-së, që pakot me fletëvotime të pranohen nga KQZ-ja, para ditës së zgjedhjeve, që në këtë rast siç edhe u konstatua me lart 4,639 pako me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, janë pranuar nga KQZ-ja, pas afatit të përcaktuar ligjor.

Nga arsyet e theksuara me lart, e bazuar në nenin 115, 117, 118 dhe 122 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.375-2/2019 më datën 28.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.